

# Indeksi i Çmimeve të Importit

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional .....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave .....	10
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	11
Aneks .....	12

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Çmimeve, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Rovena Gjyshi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialiste në Sektorin e Çmimeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:rgjyshi@instat.gov.al">rgjyshi@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	06.03.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	06.03.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	06.03.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas. Të gjitha të dhënat nën këtë titull janë të dhënat e indeksit. Në dispozicion janë dhe ndryshimet në përqindje (tremujore dhe vjetore). Të dhënat e indeksit paraqiten në formë tremujore dhe vjetore.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i përdorur për Indeksin e Çmimeve të Importit është Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2).

	<p>Çmimet e importit mblidhen, përpunohen dhe publikohen në bazë të Klasifikimit të Produkteve sipas Aktiviteteve (NP 2008 e njehsuar me CPA 2008). Mallrat janë klasifikuar në aktivitete individuale NP nga fusha e produkteve (klasa, grupe, ndarjet, nënseksionet dhe seksionet). Produktet janë klasifikuar nga aktiviteti në të cilin ato janë importuar. Klasifikimi i produkteve sipas aktiviteteve ku janë importuar lejon përputhshmërinë midis klasifikimit NP 2008 dhe NVE Rev.2.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Mbledhja e të dhënave bëhet sipas rregullores 1165/98 e cila është miratuar në vitin 1998 dhe është ndryshuar në vitin 2005 me Rregulloren 1185/2005. Të dhënat publikohen në nivel 2-digjit sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2), një klasifikim ky standart i BE-së për aktivitetet ekonomike. Klasifikimi i Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik KP 2008:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Industri nxjerrëse – B: 05 – 09</li> <li>• Industri përpunuese – C: 10 – 34</li> <li>• Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar – D: 35</li> <li>• Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, E: 36- 38.</li> </ul>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Indeksi i Çmimeve të Importit.</b> Indekset e çmimeve të importit masin ndryshimet në çmimet e importeve. Import është çdo produkt që nuk është prodhuar në Shqipëri, por që është importuar nga një vend i tretë apo furnizuar nga një tjetër. Çmimi relativ është indeksi më i thjeshtë i ndryshimit të çmimit në përqindje të një produkti në dy periudha kohe të dhënë, ku njëra prej tyre përbën periudhën bazë.</p> <p><b>Peshimi.</b> Mesatarja e peshuar aritmetike e indekseve elementare të produkteve individuale formon indeksin. Indeksi që krahason çmimet e periudhës korente me çmimet e dhjetorit të vitit të mëparshëm (short - term - link) për nivelin 6 shifror sipas NVE Rev.2 është llogaritur duke shumëzuar çdo peshë të produktit në nivel 6 shifror me çmimin relativ korespondues dhe duke pjesëtuar shumën e tyre me shumën e peshave. Periudha bazë e Indeksit është periudha për të cilën indeksi është i barabartë me 100. Periudha referuese e çmimeve është periudha për të cilën merret informacioni mbi çmimet për llogaritjen e indeksit. Periudha referuese e peshave është periudha të cilës i është referuar marrja e informacionit për ndërtimin e peshave të produkteve.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësia statistikore janë ndërmarrjet të cilat furnizojnë ose importojnë produkte nga tregjet e huaja. Anketa mbulon të gjitha ndërmarrjet industriale që kryejnë edhe aktivitete tregtar. Një nga kushtet që duhet të plotësohet në mënyrë që një ndërmarrje të përfshihet në studim është që ajo të furnizojë tregun shqiptar me produkte.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Të gjithë ndërmarrjet aktive në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Seksionet: B, C, D, E sipas NVE</p>

	Rev.2.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e IÇI përfshijnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Seria kohore nga viti 2012 e në vazhdim sipas NVE Rev2.
3.9. Periudha bazë	Periudha bazë për IÇI është viti 2020 = 100.
<b>4. Njësia matëse</b>	Njësiti matëse janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Indekset</li> <li>• Ndryshim tremujor në përqindje</li> <li>• Ndryshim vjetor në përqindje.</li> </ul>
<b>5. Periudha e referencës</b>	Frekuencë tremujore me periudhë reference mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2022.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore për indikatorët e IÇI është: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026</a></li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Këshilit Evropian Nr.1165/98</a>, “Mbi treguesit Afatashkurtër”;</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1503/2006</a> për Statistikat Afatshkurtra që përcakton variablat dhe frekuencën e publikimit të të dhënave</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e IÇI transmetohen në EUROSTAT.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë

	<p>numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerret të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloren, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p><b>8. Politika e botimit</b></p>	
<p>8.1. Kalendari i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve</p>	<p><a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesit i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë,</p>

	<p>përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshtësia e shpërndarjes</b>	Shpeshtësia e shpërndarjes së të dhënave është me frekuencë tremujore dhe vjetore.
<b>10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas Kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Indeksit e Çmimeve të Importit. Formatit i njoftimit për shtyp është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i IÇI publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet e IÇI në faqen e internetit të INSTAT si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Shifrat</a></li> <li>• <a href="#">Indeksi i Çmimeve të Importit</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e IÇI aksesohen në format excel duke filluar nga seria kohore 2012. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Të dhënat mbi IÇI të miratuara publikohen në faqen zyrtare të INSTAT: <a href="#">Databaza</a>
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e IÇI nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Të dhënat mikro i jepen përdoruesve të veçantë pas plotësimit të formularëve standard. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet: <a href="#">Kërkesë të dhënash</a>

10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur, me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">metodogjinë</a> mbi vrojtimin e Insdeksit të Çmimit të Importit.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Çmimeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e IÇI (Indeksit të Çmimeve të Importit) për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi është i përfshirë në faza të ndryshme si mbledhja e të dhënave, kontrolli i të dhënave, futja e të dhënave dhe kontrollet e tjera të nevojshme, dhe të gjithë janë të trajnuar mirë.</p> <p>Proçeset e monitorimit për dimensionet e cilësisë (p.sh. vlerësimet e afateve kohore) ekzistojnë. Janë bërë në mënyrë periodike rishikime për të identifikuar masat që mbajnë dhe përmbushin më tej kërkesat e cilësisë.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e IÇI-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike;</li> <li>• Universitetet;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare;</li> <li>• Bizneset;</li> <li>• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e IÇI- së si input në punën e tyre. Këto janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Indekset e Çmimeve të Importit për vitin 2022 janë rreth 6,635 klikime.</p> <p>Gjatë 2022 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme të statistikave të Indeksit të Çmimeve të Importit është vlerësuar me 3.67 (or 73.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për IÇI 2022, është 100%. Kjo përlloraritje ka marrë në konsideratë raportin e numrit të treguesve të llogaritur nga INSTAT kundrejt numrit të treguesve që kërkohen nga rregullorja evropiane.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Saktësia e përgjithshme e të dhënave të IÇI konsiderohet të jetë e lartë veçanërisht në saktësinë metodologjike të burimit të peshave dhe çmimeve dhe llogaritjes në përputhje me Rregulloren Evropiane.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet. Gabimet e kampionimit për Indeks të Çmimeve të Importit nuk mund të llogariten për shkak se anketa nuk është e bazuar në një përzgjedhje të rastësishme por në metodën e zgjedhjes threshold.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Gabimet të cilat nuk janë të kampionimit, janë kryesisht gabime që ndodhin gjatë matjeve ose refuzimeve. Këto gabime vlerësohen dhe krahasohen me rezultatet e periudhave të mëparshme. Për të marrë informacionin korrekt dhe për të rritur normën e përgjigjeve, ndërmarrjet kontaktohen me telefon ose intervistim të drejtëpërdrejtë.</p> <p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e</p>



	<p>mospërgjegjes në nivel rekordi për IÇI 2022 është 9.1%.</p> <p>Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për IÇI 2022 është 0.7%.</p>
--	---

#### 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Indeksi i Çmimeve të Importit janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 65 ditë pas periudhës referuese (T + 65 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksit të Çmimeve të Importit është 31 Dhjetor, 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/6/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>65</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	3/6/2023	Afatet kohore	65
Periudha referuese	12/31/2022						
Data e publikimit	3/6/2023						
Afatet kohore	65						

14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Importit publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Indeksit të Çmimeve të Importit ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/6/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/6/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	3/6/2023	Data e publikimit	3/6/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	3/6/2023								
Data e publikimit	3/6/2023								
Vonesa në kohë	0								

#### 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Në kampionin e Indeksit të Çmimeve të Importit është konsideruar dhe përfshirë i gjithë territori i vendit. INSTAT përdor aspektet metodologjike të cilat janë të bazuara në konceptet, përkufizimet dhe udhëzimet e Parlamentit Europian dhe Rregulloren e Këshillit në lidhje me SASH. Prandaj Indekset e Çmimeve të Importit të publikuara mund të jenë të krahasueshme me vendet e tjera.</p>
-----------------------------------	--

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat e IÇI ofrohen çdo tre muaj dhe çdo vit dhe janë të krahasueshme mes tyre. Seria kohore për IÇI ekziston nga viti referencë 2012 (2020 = 100), duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 11 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=11).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
------------------------------	--

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk disponohet.
--	-----------------

15.4. Koherenca e brendshme	Të dhënat e çmimeve të Importit janë të krahasueshme me të dhënat statistikore të Indeksit të Vlerës Njësi të Tregtisë së Jashtme. Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	<p>Personat që punojnë për anketat e çmimeve: IKN, IÇP, IÇI dhe IÇSH: Gjithsej: 73 punonjës</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi i përgjithshëm në zyrat qendrore: 3 punonjës</li> <li>• Intervistuesit 52 nga të cilët: 40 anketues afatgjatë dhe 12 afatshkurtër</li> <li>• Operatorët 9 punonjës</li> <li>• Kontrollorë 9 punonjës</li> </ul>
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. E njëjta politikë rishikimi zbatohet për të dhënat në nivel kombëtar dhe ato të transmetuara në Eurostat. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	Të dhënat e publikuara konsiderohen përfundimtare dhe nuk mund të rishikohen.
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimet për zgjedhjen e ndërmarrjeve janë Anketa Vjetore mbi prodhimin industrial dhe të dhënat Doganore.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen tremujore me informacion mujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Grumbullimi i të dhënave realizohet nëpërmjet Anketës së Çmimeve të Importit. Mbledhja e rregullt e të dhënave të çmimeve normalisht rrjedh nga një kampion i njësisive dhe një kampion i produkteve të tyre. Ndërmarrjet plotësojnë çmimet në pyetësorë çdo tremujor me të dhënat për çdo muaj nga një intervistë ballë për ballë e anketuesit me personin e kontaktit të ndërmarrjes. Çdo pyetësor është përgatitur individual për ndërmarrjen.

18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Verifikimi i çmimeve: çmimet e mbledhura krahasohen me trendin e tyre historik, ndryshimet e çmimeve për produkte të ngjashme dhe njohuri të tjera të fituara nga analistët; ndryshimet e pabesueshme të çmimeve verifikohen me njësinë raportuese. Njësitë raportuese verifikojnë çmimet e produkteve nga çmimet e raportuar për të dy muajt aktual e të kaluar dhe, nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim, këto ndryshime duhet të shpjegohen në pyetësor. Në INSTAT, çmimet kontrollohen në pyetësorë, gjatë futjes së të dhënave dhe me telefon në rastet kur pyetësori nuk është plotësuar si duhet.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p><b>Në nivel kombëtar:</b>  Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga intervistuesit. Qëllimi është sjellja e këtij informacioni në nivel statistikor. Ky proces vijon si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli fizik i pyetësorëve</li> <li>• Kontrolli logjik i pyetësorëve (kontrollin e indikatorëve, përshkrimin dhe kodifikimin e aktivitetit, dhe kontrollin e vlerave të sakta.)</li> <li>• Procesi i editimit të të dhënave të mbledhura (gabimet dhe modifikimet)</li> <li>• Njësitë që refuzojnë dhe informacioni që mungon duhet të plotësohet përmes procesit të imputimit.</li> <li>• Analiza e rezultateve sipas çdo domeni të publikimit.</li> </ul>
18.6. Rregullimi	<p>Mungesa e çmimeve: Në rastet e mungesës së çmimit të një produkti për imputim përdoret çmimi i muajit të mëparshëm. Zëvendësimi i produkteve që ndërmarrja nuk i prodhon më: Nëse produkti bëhet i padisponueshëm, kryhet zëvendësimi i tij me një produkt, i cili ka karakteristika të ngjashme me të dhe bën pjesë në të njëjtin grup 6 - shifror sipas NP. Zëvendësimi realizohet në bashkëpunim me njësinë statistikore. Për produktin zëvendësues merret informacion për çmimin në periudhën e mëparshme. Rregullimet e cilësisë aplikohen kur vërehen diferenca të çmimit si pasojë e ndryshimit të cilësisë së produktit. Nga njësia statistikore kërkohet një vlerësim i ndryshimit në cilësinë e produktit. Ky informacion përdoret për aplikimin e metodave të rregullimit cilësor. Produktet e reja: Produktet e reja përfshihen në fund të vitit dhe janë pjesë e kampionit për periudhën pasardhëse. Produktet sezonale: Çmimi i fundit i vrojtuar për produktin sezonal përdoret për llogaritjen e indeksit deri në momentin kur produkti rishfaqet në treg.</p> <p>Të dhënat nuk janë të përshtatura sezonalisht: Nuk aplikohet.</p>
<b>19. Komentë</b>	

**Aneks**